



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndertimi i shkolles 9-vjeçare" Ismail Veizi" Babunj, Bashkia Divjake” .

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): CPV 45214200-2 Punime ndërtimi për shkolla, CPV 45212222-8 Punime ndërtimi për palestra

VLERA E FONDIT LIMIT:65 814 708(gjashtëdhjetë e pesë milion e tetëqind e katëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) Lekë pa Tvsh nga Granti nga e cila:

- 1 -Ministria e Arsimit dhe Sportit: 52 651 766 (pesëdhjetë e dy milion e gjashtëqindë e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqindë e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh nga Granti**
- **Për Vitin 2024: 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë pa Tvsh nga Granti**
 - **Për Vitin 2025 :37 651 766 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh nga Granti**
- 2- Bashkia Divjakë :13 162 942(trembëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e dyzet e dy) lekë pa Tvsh nga Granti**
- **Për Vitin 2024: 4 166 667 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtë gjashtëdhjetë shtatë) Lekë pa Tvsh nga Granti**
 - **Për Vitin 2025: 8 996 275 (tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) Lekë pa Tvsh nga Granti**

Argumentimi: Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin e përlllogaritur mbështetur në Nenin 76, pika 1, gërma a të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si edhe në VKM nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Divjakë, ka hartuar procesverbalin për

argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP, si edhe në nenin 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si edhe në nenin 39, pika 6/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si edhe në nenin 43 pika 1, pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- Vlerën e përlllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, bazuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si edhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, mbi bazën e të cilave, AK mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve, është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si edhe kërkesave të Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2024.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2024, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose

palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje.
- Situacionin përfundimtar.
- Faturat tatimore.
- Aktin e kolaudimit.
- Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrata përkatëse.
- Situacioni përfundimtar.
- Fatura tatimore që i korespondon situacionit përfundimtar.

- Akt kolaudimi.
 - Formular vlerësimi.
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh Ekonomikë, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
 - Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$65\ 814\ 708 \times 50\% = 32\ 907\ 354 \text{ Lekë pa Tvsh}$$

$$65\ 814\ 708 \times 2 = 131\ 629\ 416 \text{ Lekë pa Tvsh}$$

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh Ekonomikë, operatorit ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni, AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P - 1 A** Punime gjurmimi në tokë
- **N.P - 2 B** Ndërtime civile e industriale
- **N.P - 3 A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash.

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S - 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues
- **N.S - 6 A** Sinjalistika rrugore jodriçuese
- **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- **N.S - 18 A** Punime topogjeodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit që merr përsipër të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si edhe në VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 1 A “Punime gjurmimi në tokë”:** *Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv të objektit “PUNIME TË NDERTIMIT TE PALESTRES” dhe “PUNIME TE NDERTIMIT TE FUSHES (KALCETOS)” tek rubrika “Punime dheu”, konkretisht këtu përfshihen zërat me emërtesë:

- Gërmim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III
- Gërmim dheu themele plinta b-2 m ekskavator me gova kova 0.25m3 shkarkim ne toke

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 2 B “Ndërtime civile e industriale”**: *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderrur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv të objektit “PUNIME TE NDERTIMIT TE SHKOLLES” konkretisht këtu përfshihen zërat me emërtesë në preventivat:

- Brez b/a mbi themel
- Brez b/a mbi mure
- Plinta bazamente b/a monolite deri 20m3 C20/25
- Arkitrare b/a
- Trare themeli b/a
- Trare Solet
- Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm + rrjete + suva
- Boje hidroplastike cilesi e larte

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 3 A “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”**: *Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim .*

Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv konkretisht ketu përfshihet zeri me emertese tek “PUNIME TE SHKOLLES” në zërat per secilin emertesë “Punime prishjeje, Ngritje kantieri , punime betoni dhe betonarmeje, Punome murature, Punime tarace dhe hidroizolim, Punime shtresash, Punime suvatimi dhe veshje, Punime Bojatisje, Punime dyer dritare “ etj.

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”**: *Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve*

në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht “PUNIME DHEU DHE PRISHJE” të seksionit me emërtesë “Heqje dritaresh + largim nga objekti”.

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar **N.S - 2 A “Impiante hidro-termosanitare dhe mirembajtja e tyre”**: *Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

Në këtë kategori punimesh përfshihen krijimi i nyjeve të reja hidrosanitare dhe lidhja e tyre me rrjetin ekzistues të ujit dhe lidhja gjithashtu me gropën e re septike që do të përtohet për këto ambiente si dhe montimi i të gjitha pajisjeve hidrosanitare të parashikuara në projekt.

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 4 A “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese”**: *Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.*

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht këtu përfshihen zërat e punimeve të preventivit me emërtesë “PUNIME SUVATIMI VESHJE” dhe “PUNIME TE NDRYSHME” në zërin “Punime murature”, “Punime shtresash”, “Punime suvatimi”, “Punime bojatisje”, “Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm + rrjete + suva”.

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 6 A “Sinjalistika rrugore jodriçuese”**: *Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht këtu përfshihen zërat e punimeve të preventivit me emërtesë “Rik. i ambjentëve të jashtëme dhe krijimi i hapësirave stërvitore” në zërin “Punime të fushës multisportive” (vizime me bojë resina acrilica Mapecoat TNS Line d=8cm me tre ngjyra sipas disiplinave ose ekuivalent).

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht “PUNIME ELEKTRIKE/INTERNET/TELEFON” dhe “PUNIME TE SISTEMIT TE NGROHJES”. Në këtë kategori përfshihen të gjitha punimet të rrjetit të ndriçimit dhe shtimit të linjave 3-fazore për të furnizuar objektet ekzistuese dhe palestrën e re, sistemimet e jashtme dhe djegësin e kaldajes, të gjitha paketat e kontrollit të ambienteve të brendshme të parashikuara sipas projektit.

O.E fitues pas përfundimit të instalimit të impianteve teknologjike nën presion duhet të pajisë me certifikatën e konformitetit. Subjekti duhet të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe miratuara nga Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë në (V.K.M. nr.1062, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” (aneksi V) për paisjet nën presion nga organe të akredituara dhe miratuara nga Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë).

Kjo kërkesë është e bazuar në Ligjin nr.32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 14 A “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV”**: *Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht “PUNIME ELEKTRIKE/INTERNET/TELEFON” dhe “PUNIME TE SISTEMIT TE NGROHJES”. Në këtë kategori përfshihen të gjitha punimet të rrjetit të ndriçimit dhe shtimit të linjave 3-fazore për të furnizuar objektet ekzistuese dhe palestrën e re, sistemimet e jashtme dhe djegësin e kaldajes, të gjitha paketat e kontrollit të ambienteve të brendshme të parashikuara sipas projektit.

O.E fitues pas përfundimit të instalimit të impianteve teknologjike nën presion duhet të pajisë me certifikatën e konformitetit. Subjekti duhet të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe miratuara nga Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë në (V.K.M. nr.1062, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” (aneksi V) për paisjet nën presion nga organe të akredituara dhe miratuara nga Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë).

Kjo kërkesë është e bazuar në Ligjin nr.32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.

Sipas VKM nr.42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 18 A “Punime topogjeodezike”**: *Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht këtu përfshihet zërat e punimeve “PUNIME BETONIE BETON/ARMEJE (SHTESA)+PALESTRA” të seksionit me emërtesë piketimi i akseve të objektit që shërbejnë për kolonat, traret dhe mureve të tullës.

Licencat për punimet speciale të ndërtimit janë kërkuar bazuar në zërat e punimeve të preventivit, referuar vlerave të preventivuara për këtë kategori licence.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 1 A	Punime gjurmimi në tokë	<ul style="list-style-type: none"> - Gjurmim dhe me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III - Gjurmim dhe themele plinta b-2m 0.25m3 shkarkim ne toke 	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.P - 2 B	Ndërtime civile e industriale	<ul style="list-style-type: none"> - Brez b/a mbi themel - Brez b/a mbi mure - Plinta bazamente b/a monolite deri 20m3 C20/25 - Arkitrare b/a - Trare themeli b/a - Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm = rjete =suva - Boje hidroplastike cilesi e larte - Cati vendi zakonshme HD-8m mbuluar me tjegulla vendi. 	B	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar
N.P - 3 A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	“Punime prishjeje”, Ngritje kantieri, Punime betoni dhe betonarmeje, Punime murature, Punime murature, Punime tarace dhe hidroizolim, punime shtresash, Punime suvatimi dhe veshje, Punime Bojatisje, Punime dyer dritare “ etj.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar
N.S - 1 A	Punime për prishjen e ndërtimeve	“Heqje dritaresh +largim nga objekti”	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar

N.S - 4 A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues	“Punime murature”, “Punime shtresash”, “Punime suvatimi”, “Punime bojatisje”, “Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm + rrjete + suva”.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.S - 6 A	Sinjalistika rrugore jo ndricuese	Përfshin natyrën e punimeve “Rik. i ambjenteve të jashtëme dhe krijimi i hapësirave stërvitore” dhe i referohet zërave “Punime të fushës multisportive” (vizime me bojë resina acrilica Mapecoat TNS Line d=8cm me tre ngjyra sipas disiplinave ose ekuivalent).	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.S - 8 A	Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri	Mbulim çatie me panele sanduich, Konstruksion metalik (, mbulimi I palestres), Galvanizim konstruksion metalik.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.S - 14 A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	“Punime elektrike” FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm, F V pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm, Tub fleksibel Ø 64 mm, F.V te kuadrit elektrik me automat mgt 4p 32A, automat diferencial 4p 40A 5d=0,3A, 4 automatë mgt 1p 16A 16kA, 4 kontaktorë modular 4p 40A, 4 çelësa seksionues 1p 16A, Tub fleksibel Ø 90 mm, Kabell FGOR 3x2.5mm, Kabell FGOR 3x6mm, "F.V prozhektore asimetrik me llampe joduro metalike me stafa mbeshtetese. Fluksi I nje llampe 30.5klm, fuqia 400ëa" .	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.S-18 A	Punime Topogjeodezike	Piketimi i akseve të objektit që shërbejnë për kolonat, traret dhe mureve të tullës.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (dy)
- Arkitekt 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune, Diplomën Universitare dhe CV.
- Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr.42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën për 3 (tre) muajt e fundit
- Njëri nga Drejtuesit teknik duhet të jetë i pajisur me certifikatë për Auditues energjie në ndërtesa, i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të Ligjit nr.124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” parashikohet se: “2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”. Bazuar në preventivin e objektit është parashikuar vendosja e catisë, ndërrimi i dritareve dhe veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm + rrjete + suva, të cilat janë bazë për një vlerësim paraprak sipas projektit të zbatimit dhe atij përfundimtar që dorëzohet në përfundim të punimeve dhe e realizon Audituesi energjisë në përfundim të punimeve.
Audituesi i energjisë mund të disponohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore për ekzekutimin e kësaj kontrate objekt prokurimi. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratën përkatëse të punës dhe certifikatë për Auditues energjie në ndërtesa.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor,

referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- | | |
|--|---|
| - Inxhinier Ndertimi | 1 (një) |
| - Teknik Ndërtimi | 1 (një) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Teknik Mekanik | 1 (një) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Teknik Elektrik | 1 (një) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Hidraulikë | 2 (pesë) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Karpentier | 2 (dy) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Hekurkthyes | 2 (dy) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Saldator dhe prerës të metaleve | 2 (dy) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Hidroizolues | 1 (një) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Suvatues | 2 (dy) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Bojaxhi | 1 (një) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Pllakashtrues | 1 (një) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Murator | 2 (dy) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Punëtor Duralumini | 1 (një) me Dëshmi /Çertifikatë Profesionale, |
| - Punëtor ndërtimi dhe profesione të lidhura me to | 4 (tetë) |

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore;
- Staf i mësipërm duhet të jetë i përfshirë në listëpagesa për 3 (tre) muajt e fundit
- Për punonjësit Specialist Kaldaje duhen të jenë të pajisur me Dëshmi Aftësie për enët nën presion, konkretisht për kaldajat, kjo gjë konform Ligjit 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licencuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

Argumentimi: Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 39, pika 6, gërma c dhe ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si edhe VKM nr.514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohej në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve.
- **Arkitekti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të ndarjeve dhe interireve të brendshme dhe zbatimin sipas detajeve arkitektonike të fasadës lidhur me zërat e preventivit të punimeve (Ndërtim e palestrës, ambjenteve sportive, punime catie, punime shtresash, punime betoni e beton/armeje (shtesa)+palestra, punime murature(shtesa)+palestra, punime dyer e dritare, punime te ndryshme).
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike lidhur me zërat e preventivit të punimeve (Punime hidrosanitare).
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve elektrike, referuar preventivit të punimeve (Punime elektrike).
- **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi, referuar preventivit të punimeve (Punime dheu dhe prishje, punime betoni e beton/armeje (shtesa)+palestra, punime shtresash).

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve (Punime dhe dhe prishje, punime murature(shtesa)+palestra, punime catie, punime betoni e beton/armeje (shtesa)+palestra).
- **Teknik Mekanik** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve mekanike, sipas zërave të preventivit të punimeve (Punime te sistemit te ngrohjes).
- **Elektrici** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve elektrike, për instalimin e rrjeteve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve (Punime elektrike/internet/telefon).
- **Hidrauliku** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve (Punime hidrosanitare).
- **Karpiert** janë të nevojshëm për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementeve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet, sipas zërave të preventivit të punimeve (Punime betoni e beton/armeje (shtesa)+palestra).
- **Hekurkthyesi** është i nevojshem për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin sipas zërave të preventivit të punimeve (Punime betoni e beton/armeje (shtesa)+palestra).
- **Saldator dhe prerës të metaleve** janë të nevojshëm për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve (Punime te ndryshme).
- **Hidroizoluesi** është i nevojshëm për realizimin e punime të termo-izolimit me materialin e duhur sipas zërave të preventivit të punimeve (Punime shtresash).
- **Suvatuesi** është i nevojshëm për realizimin e suvatimeve, sipas zërave të preventivit (Punime suvatimi veshje).
- **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lysterjes, sipas zërave të preventivit (Punime te ndryshme).
- **Pllakashtruesi** është i nevojshëm për realizimin e shtrimit të pllakave, sipas zërave të preventivit (Punime shtresash).
- **Muratori** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të muraturës, sipas zërave të preventivit (Punime murature(shtesa)+palestra).
- **Specialist Kaldaje** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të ndërtimit te kaldajes, sipas zërave të preventivit (Punime te sistemit te ngrohjes).
- **Punëtor Duralumini** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të dritareve duralumini, sipas zërave të preventivit (Punime dyer e dritare).
- **Punëtor ndërtimi dhe profesione të lidhura me to** janë të nevojshëm për realizimin e çdo punimi tjetër që nuk ka nevojë për specialistë të profesioneve të sipërcituara, apo si ndihmesa në realizimin e punimeve nga specialistët në fjalë.

c) Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklarate nga (Administratori i shoqërisë), **Përgjegjësin Teknik të Kantierit**, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit i

deklaruar, duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Argumentimi: Kërkesa e shkronjës c), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim është bazuar në Kreun I/2.1 të Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, përcaktohet se “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

d) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10237 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratën e punës.
- Diplomën/Certifikatën përkatëse.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6 gërma c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- e) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre **1 (një) mjek të përgjithshëm**, bazuar në VKM nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratën e individuale të punës.
- Diplomën universitare.
- Licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.

Nëse OE nuk kanë në stafin e tyre persona përgjegjës me aftësi dhe kualifikimet e duhura lidhur me çështjet e shëndetit në punë (nëse nuk kanë mjek të punësuar) mund ti sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënieve kontraktore (të paraqitet kontrata e vlefshme, diploma universitare dhe licenca përkatëse për ushtrimin e profesionit) me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e shkronjës e), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekesore për stafin e tyre, nëpërmjet punësimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

f) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre **1 (një) ekspert zjarrfikës të shoqëruar me certifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit lëshuar nga PMNZH.** Eksperti zjarrfikës mund të disponohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratën përkatëse të punës;
- Certifikatë/dëshmi kualifikimi.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e shkronjës f), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6 gërma c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar referuar natyrës që parashikon projekti me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kjo kërkesë është vendosur referuar zërave të punimeve të parashikuara në preventivin “Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit”.

g) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë:

- Manovrator 1 (një)
- Shofer 1 (një)

(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me Urdhërin nr.200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Kërkesa e shkronjës g) është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6 gërma c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me Urdhërin nr.200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

h) Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre jo domosdoshmërisht në licencën e shoqërisë dhe listëpagesat përkatëse **1 (një) inxhinier ndërtimi profil**, të cilin mund ta marrë edhe me kontratë pune me afat që të mbulojë kohën e ndërtimit të objektit.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratën individuale të punës;
- Diplomë/Dëshmi përkatëse kualifikimi për sizmik.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

i) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore me kohë të plotë prej minimalisht **40 (nëntëdhjetë)** punonjësish (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues). Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit . Përjashtim nga kjo bën vetëm “Mjeku i përgjithshëm”, i kërkuar sipas gërmës “e”, i cili përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listëpagesat e tij) mund të jetë edhe me kontratë pune individuale. Ndërsa punonjësit e kualifikuar si (Manovrator dhe Shofer), të kërkuar sipas gërmës “g”, të cilët përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listëpagesat e tij) mund të jenë të kontraktuar vetëm në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera.

Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë:

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 (tre) muajt e fundit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6 gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si edhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga shoqëria projektuese. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore si dhe përvojën e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3,5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me kapacitet mbajtës 3.5-7 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Ekskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Fadromë me goma	2 copë	Në pronësi ose me qera
5	Autobetoniere	2 copë	Në pronësi ose me qera
6	Autopompë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Depozitë Uji 3000-5000 lita	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Betoniere kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qera
9	Moto/Gjenerator	2 copë	Në pronësi ose me qera
10	Vibrator betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
11	Saldatriçe	2 copë	Në pronësi ose me qera
12	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
13	Kamion me vinc me peshëmbajtje mbi 5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
14	Minieskavator	1 copë	Në pronësi ose me qera
15	Minifadromë	1 copë	Në pronësi ose me qera
16	Rul gome hekur mbi 10 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
17	Rul hekur hekur deri 4 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
18	Rimorkiator	1 copë	Në pronësi ose me qera/kontratë bashkëpunimi
19	Instrument për matje Topografike	1 copë	Në pronësi ose me qera
20	Skela	1200m2	Në pronësi ose me qera
21	Zyrë e lëvizëshme (kontenier)	1 copë	Në pronësi ose me qera

- Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton - Për transport materiale të imta si elektrike hidraulike.
- Kamion me kapacitet mbajtës 3.5-7 ton - Për transport heqje dhe largimi të dritareve nga objekti.
- Ekskavator me goma - Shpërndarje nivelim cakulli, gërmime në sasira të vogla kryesisht për sistemime.
- Fadromë me goma - Për sistemime, nivelime të terrenit si dhe për ngarkesa të shpejta.
- Autobetoniere - Për transportin e betonit në objekt.
- Autopompë betoni - Për ngritjen e betonit në lartësi, për brez betoni mbi mure.
- Depozitë Uji 3000-5000 lita - Për nevojat e kantierit, lagjen e betonit, etj.

- Betoniere kantieri - Për përdorim të prodhimit të betonit për nevoja të vogla brenda kantierit.
- Moto/Gjenerator - Për prodhim energjie për nevojat e kantierit.
- Vibrator betoni - Për vibrimin e betonit për plintat, traret e themelit, brezat e trareve të themelit, brezat e trareve mbi mure.
- Saldatriçe - Për fiksimin e konstruksionit metalik.
- Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton - Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri t= 30 cm.
- Kamion me vinc me peshëmbajtje mbi 5 ton - Për ngarkim shkarkim të materialeve të ndërtimit për nevojat e kantierit.
- Minieskavator - F.V Tuba PVC Ø 315 mm për linja të jashtme.
- Minifadromë - Për lëvizjen e dherave brenda kantierit.
- Rul gome hekur mbi 10 ton - Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri t= 30 cm.
- Rul hekur hekur deri 4 ton - Për ngjeshjen shtrese asfalto betoni.
- Rimorkiator - Për transportin e makinerive të rënda dhe të konstruksionit metalik.
- Instrument për matje topografike - Për piketimin e objektit, kuotat, nivelimet, etj.
- Skela - Për veshje fasade me polisterol, për lyerjen me bojë, suvatime të objektit dhe për shërbime të tjera në lartësi.
- Zyrë e lëvizëshme (kontenier) - Për nevojat e drejtuesit teknik dhe të stafit drejtues të kantierit.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet:

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimit të mjetit dhe foto të tyre.

Mjetet, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë objekt tjetër dhe do anagazhohen vetëm për realizimin e këtij objekti.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6 gërma d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i fuqisë punëtore i kërkuar, mjetet dhe pajisjet e kërkuara, janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike, operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme, janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe menaxhimit e sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

- Certifikatë **ISO 45001:2018** mbi “Shëndetin dhe Sigurimin në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën , OE duhet ta paraqesin atë.

Vendosja e ISO 45001:2018 përfaqëson një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të kompanisë me udhëzime për përdorimin e tij, për të mundësuar një organizatë që të përmirësojë në mënyrë proaktive performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të saj. Në këtë kuptim, AK në vendosjen e këtij kriteri kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses dhe në afat të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë, të cilët duhet të dëshmojnë performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të tyre.

Vendosja e ISO 14001:2015 na shërben për shkak se është e lidhur me mjedisin. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda më e thjeshtë dhe me efikasitet për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi menaxhimi për mjedisin në konformitet me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO 14001. Përfitimet kryesore për këtë sistem menaxhimi janë: paraqitja e angazhimit për mbrojtjen e mjedisit nga klienti, investitorët potenciale, komuniteti, autoritetet; zvogëlimin e shpenzimeve nëpërmjet përmirësimit të administrimit mbeturinave dhe uljen e konsumit të burimeve; parandalimin e incidenteve të mundshme që mund të cojë në pagesën për dëmshpërblim dhe dëme; përmirësimin e marrëdhënieve me autoritetet; mundësi për hyrje në tregje të reja. Për sa më sipër, vendosja e kësaj ISO është në proporcion me objektin që AK po prokuron.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë, standardet e menaxhimit të mjedisit dhe standardet e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin

publik”, si edhe në nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standartet e menaxhimit të mjedisit.

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT